

VENDIM
Nr.1045, datë 22.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.807, DATË 6.10.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR LEVAN – TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.807, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Vlera e tokës arë, nga 34 391 180 (tridhjetë e katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, bëhet 36 697 484 (tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

b) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 63 521 159.52 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e dy) lekë, bëhet 65 827 463.52 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e dy) lekë.

2. Në listën e fshatit Malas, bashkëlidhur vendimit nr.807, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Çmimi i tokës arë, nga 659 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë/m², bëhet 857 (tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë/m².

b) Vlera e tokës arë, nga 7 676 032 (shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e dy) lekë, bëhet 9 982 336 (nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

c) Vlera e përgjithshme e shpronësimit për fshatin Malas, nga 8 201 887 (tetë milionë e dyqind e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, bëhet 10 508 191 (dhjetë milionë e pesëqind e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.

3. Diferenca prej 2 306 304 (dy milionë e treqind e gjashtë mijë e treqind e katër) lekësh, që i shtohet vlerës së përgjithshme të shpronësimit prej 63 521 159.52 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e dy) lekësh, të miratuar me vendimin nr.807, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas masës së kompensimit të paraqitur në listën bashkëlidhur këtij vendimi, pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë të pronësisë nga pronarët respektivë.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha